


DISCOVER
— ITS BEAUTY —

Pjesa 1

A large iceberg floats in a blue ocean under a bright blue sky with a sunburst effect. The tip of the iceberg is above the water, while the much larger, jagged base is submerged. The title text is overlaid on the iceberg.

VETËM MAJA E AJSBERGUT

DR. NAXHI IBRAHIM



VETËM MAJA E AJSBERGUT

- Na frymëzon të kemi qëllime të mira, qëndrime pozitive dhe ndjenja të mira ndaj të tjerëve.
- Na mëson t'i falim të tjerët dhe të duam për ta, atë që duam për vete.
- Na nxit të buzëqeshim sinqerisht dhe të jemi të gëzuar dhe optimistë.
- Na udhëzon të veprojmë dhe të sillemi me të tjerët me mirësjellje dhe respekt.
- Na urdhëron të kemi sjellje të mira me njerëzit.
- Na mëson të jemi të butë me kafshët, zogjtë dhe ambientin ku jetojmë.
- Na udhëzon t'i respektojmë dhe të sillemi mirë me prindërit tanë dhe të moshuarit si dhe të jemi të mirë me gratë, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes.

A jeni kureshtar të dini rreth tij? Me lejoni t'ju tregoj pak më shumë! Ai gjithashtu:

- Inkurajon t'i ndihmojmë, ushqejmë dhe mbështesim të dobët, të varfërit, nevojtarët dhe të paaftët.
- Udhëzon të jemi dorëdhënës, bamirës dhe bashkëpunues.
- Nxit të jemi pozitivë duke marrë pjesë në punë vullnetare dhe në shërbim të komunitetit.
- Tregon që njerëzit më të mirë janë ata, që janë më të dobishëm ndaj të tjerëve.
- Thekson se njerëzit më të nderuar dhe më fisnikë janë ata, që janë më të devotshëm dhe të drejtë, zemrat e të cilëve janë të pastra nga xhelozia, urrejtja dhe mendjemadhësia.
- Nxit të mendojmë, të meditojmë, të arsyetojmë, t'i bazojmë besimet dhe gjykimet tona mbi argumente.



VETËM MAJA E AJSBERGUT

Përpara se ta zbuloj sekretin, më lejoni t'ju tregoj se ai, po ashtu...

- Na mëson se të gjithë njerëzit janë të barabartë, pavarësisht racës, ngjyrës apo kombësisë.
- Na ndalon të gjitha format e ndarjes dhe diskriminimit në bazë të klasave dhe racizmit.
- Na urdhëron të mbajmë siguri, të përhapim paqen dhe të jetojmë në paqe dhe harmoni mbi tokë.
- Na udhëzon të mos i shkelim të tjerët, duke iu vjedhur atyre pasuritë ose pronat.
- Ndalon vrasjen e të pafajshmëve, po ashtu tradhtinë, mashtrimin dhe thyerjen e marrëveshjeve.
- Udhëzon të shmangim urrejtjen dhe armiqësinë ndaj të tjerëve.
- Udhëzon që të mos i lëndojmë, përflasim, përqeshim apo nënçmojmë të tjerët.
- Urdhëron të mos mashtrojmë, të mos gënjejmë apo të mendojmë keq ndaj të tjerëve.
- Udhëzon në vërtetësi, drejtësi, besueshmëri, bamirësi dhe modesti.
- Udhëzon që të mbajmë lidhje të mira me Krijuesin tonë, veten dhe me të tjerët.
- Na mëson të besojmë në të gjithë të Dërguarit dhe Profetët e Allahut, Zotit të Vetëm të Vërtetë; duke përfshirë Ademin, Nuhun, Ibrahimin, Musain, Isain, dhe Muhamedin (paqja qoftë mbi ta).

Në të vërtetë, udhëzon në të vërtetën përfundimtare dhe në sukses, në qetësinë e vërtetë të shpirtit në lumturi reale, në shpëtim dhe jetë të përhershme.

Tani, më lejoni t'ju tregoj se për çfarë e kam fjalën.





Është ISLAMI!

Ata që vuajnë nga paragjykimi dhe mendjengushtësia, nuk mund ta njohin asnjëherë bukurinë ose të vërtetën e Islamit!

Ndoshta, shumë lexues tashmë kanë nocione negative të formuara për Islamin.

Ndoshta, ata e kanë parë Islamin vetëm ashtu siç është pasqyruar nga mediet, me fokus te terroristët.

Ndoshta, ata kanë lexuar apo dëgjuar për Islamin nga burime jo të mirëfillta dhe të njëanshme.

Sidoqoftë, nëse je i interesuar të zbulosh informacione më të besueshme për Islamin, të ftoj që ta lexosh në mënyrë objektive dhe me mendje të hapur, këtë broshurë dhe pjesë të tjera të serive “**ZBULOJENI BUKURINË E TIJ,**” që vërtetojnë bukurinë dhe madhështinë e Islamit, dhe të cilat qartë tregojnë të vërtetën për:

- Krijimin e universit
- Krijimin tonë
- Anën tonë shpirtërore
- Konceptin e pastër mbi Zotin
- Konceptin e adhurimit
- Qëllimin e jetës
- Rrugën drejt lumturisë dhe kënaqësisë së vërtetë, dhe stacionin tonë final në botën tjetër.



ISLAMI JEP PËRGJIGJE PËR PYETJE KRITIKE SI KËTO:

- Cila është e vërteta përfundimtare?
- Kush na krijoi?
- A ekziston Zoti?
- Kush është Zoti ynë i vërtetë?
- Kush është Profeti i fundit i Zotit?
- Kë duhet të adhurojmë?
- Kush jemi ne?
- Pse jemi këtu?
- Çfarë ndodh me ne pasi të vdesim?
- Si do të jetë bota tjetër?
- Cili është stacioni ynë i fundit, Parajsa apo Ferri?
- Si mund të arrijmë paqen shpirtërore, suksesin dhe lumturinë reale?
- Si mund të fitojmë botën tjetër?





ZBULOJE TË VËRTETËN RRETH ISLAMIT

Sa më shumë që lexon dhe mëson rreth Islamit, nga burimet e mirëfillta dhe të besueshme, aq më shumë do të zbulosh se është feja e vërtetë e Ademit dhe Havasë (Adamit dhe Evës) dhe e pasardhësve të tyre, deri në Ditën e Fundit të kësaj bote. Feja islame është e thjeshtë, logjike, e qartë, praktike dhe gjithëpërfshirëse.

Bukuria e Islamit është e pafund, sepse vjen nga Ai që s'ka fund, nga Krijuesi.

Zoti i vetëm i vërtetë, Allahu, thotë në Kuranin e bukur dhe të pandryshueshëm:

“...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj....” (Kur'ani, 5:3)

Zoti i vërtetë na tregon se Muhamedi, paqja qoftë mbi të, është Profeti i Tij i fundit, i dërguar për tërë njerëzimin (hebrenjtë, të krishterët, myslimanët, hindusët, budistët, ateistët, agnostikët dhe të tjerët). Allahu ua ofron udhëzimin dhe dritën e Tij të gjithë njerëzve. Ai zbulon sekretet dhe çelësat përmes të cilëve, ne mund të arrijmë qetësinë dhe kënaqësinë, si dhe paqen shpirtërore globale.

Islami na mëson të jemi të drejtë, të mençur, të sinqertë, të ndershëm, objektivë dhe mendjehapur në kërkim të së vërtetës.



EMRAT DHE TERMAT BAZIKË ISLAMË

Allah: Në gjuhën arabe, emri Allah është emri kryesor i Zotit të vërtetë, Krijuesit. Islami na mëson se, Allahu është Zoti i Vetëm i vërtetë i gjithë njerëzimit. Arabët, hebrenj dhe të krishterë e përdorin po kështu këtë emër (Allah) për t'iu referuar Zotit, dhe kjo fjalë përdoret për Zotin në Biblat e shkruara po ashtu në gjuhën arabe.


Muhamed: Profeti i fundit i Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut-Krijuesit), i dërguar i të gjithë njerëzimit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Kurani i Madhërishëm: Është fjala e fundit e Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), siç i është shpallur Profetit Muhamed.

Islami: Nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit, të vetëm të vërtetë (Allahut).

Myslimani: Ai që i nënshtrohet vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), dhe e adhuron vetëm Atë.

Xhamia: (mesxhidi) është një vend i pastër i gjunjëzimit (përuljes), që përdoret nga myslimanët për lutje dhe adhurim.



DËSHMIA E BESIMIT HYRJA NË ISLAM

Dëshmoj se nuk ka tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”

Në arabisht lexohet:



që në shqip tingëllon sikurse më poshtë:

**ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,
UE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULULLAH!**



Kjo është dëshmia e besimit, që duhet të deklarojmë në mënyrë që të përqafojmë Islamin; ajo përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.



A JENI ENDE KURESHTAR?

Nëse jeni kureshtar dhe të interesuar të zbuloni më shumë informacione dhe detaje rreth Islamit, ju lutem vizitoni faqen tonë:

www.discoveritsbeauty.com

Keni mirësinë të na dërgoni me e-mail pyetjet dhe kritikën tuaj:

info@discoveritsbeauty.com

SERITË E 'ZBULOJENI BUKURINË E TIJ'

- 1) Vetëm maja e ajsbergut
- 2) Feja e Ademit dhe Havasë
- 3) ABC-ja e Islamit
- 4) Përgjigje ndaj pyetjeve madhore të njerëzimit
- 5) Emrat e Tij të bukur
- 6) Shpallja e fundit
- 7) I Dërguari i fundit

WEBFAQET E DOBISHME ISLAME

<http://www.allahsquran.com>

<http://www.quranexplorer.com>

<http://www.islamhouse.com>

<http://www.edialogue.com>

<http://www.islamreligion.com>

<http://www.newmuslimguide.com>

<https://aboutislam.chat>

<https://guidetoislam.com>

DISCOVER

—ITS BEAUTY—

WWW.DISCOVERITSBEAUTY.COM



Scan it!

GLOBAL ACADEMY FOR TRANSLATION AND EDUCATION (GATE)
LONDON | THE UNITED KINGDOM

كتاب رأس الجبل الجليدي باللغة الألبانية